

LIGJ
Nr.9136, datë 11.9.2003
I NDRYSHUAR

PER MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TE DETYRUESHME TE SIGURIMEVE
SHOQERORE DHE SHENDETESORE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Ne mbështetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqërore dhe te kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shëndetësore.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kontribute të detyrueshme të sigurimeve shëndetësore” janë kontributet që paguhen në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. “Kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore” janë kontributet që paguhen në mbështetje të neneve 9 dhe 13, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. “Kontribute” janë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, pagesat e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe pagesat e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore.
4. “Numri i sigurimit shoqëror” është “Numri personal”, që ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 8951, datë 10.10.2002, “Për numrin e identitetit të shtetasve”, të ndryshuar.
5. “Organe tatimore” janë, sipas rastit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe drejtoritë rajonale tatimore.
6. “Paga bruto” është paga që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
7. “Person i detyruar për të paguar kontribute” është çdo person që detyrohet të paguajë kontributet e detyrueshme, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
8. “I vetëpunësuar” është një tatimpagues i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në organet tatimore si “person fizik”. I vetëpunësuari mund ta ushtrojë veprimtarinë ekonomike me këto statuse: “i vetëpunësuar i vetëm”, “i vetëpunësuar me punëmarrës”, “i vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes”, “i vetëpunësuar pa punëmarrës me punonjës të papaguar të familjes”. Nëkuptim të kësaj pike, termi “i vetëpunësuar” nuk përfshin personin e vetëpunësuar në bujqësi.

9. “Punëdhënës” dhe “persona të punësuar” kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

10. “Shkalla e kontributeve” janë përqindjet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të vendosura me ligjet nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

11. “Punonjës i papaguar i familjes” është anëtari I familjes në moshën e përcaktuar në legjislacionin përkatës në fuqi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që punon e bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin.”

(Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

Neni 3

Përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme

Kontributet mbliidhen nga organet tatimore për llogari te Institutit te Sigurimeve Shoqërore dhe te “Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, ne përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe te akteve te tjera nënligjore.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

Neni 4

Transferimi i kontributeve

Procedurat për transferimin e kontributeve dhe te kamatevonesave te mbledhura, sipas përcaktimit ne këtë ligj, nga organet tatimore ne Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe ne “Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, përcaktohen me vendim te Këshillit te Ministrave.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, date 9.02.2012. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 12, date 29.02.2012.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

Neni 5

Njoftimi

Organet tatimore u japin Institutit te Sigurimeve Shoqërore, “Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor” dhe Institutit te Statistikave (INSTAT) te dhënat përkatëse për mbledhjen e kontributeve. Forma dhe përmbajtja e këtyre te dhënave, si dhe kushtet dhe afatet për dhënien e tyre përcaktohen me vendim te Këshillit te Ministrave.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

KREU II

PROCEDURAT

Neni 6

Detyrimet e personave qe paguajnë kontributet

1. Personi i detyruar për te paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve ne kohen dhe ne masën e duhur.

2. Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën

ne organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit.

3. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit dhe për punonjësit e papaguar të familjes, për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Pensionistët e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9, të këtij ligji, nuk kanë detyrimin për të paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe kujdesit shëndetësor.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 143/2015, datë 17.12.2015. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 244, datë 11.01.2016.)

Neni 7 Regjistrimi

Personat juridikë dhe fizikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Dy ditë pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, personi juridik dhe fizik duhet të deklarojë në organin tatimor listën e të punësuarve, me pagën përkatëse, përfshirë dhe listën e punonjësve të papaguar të familjes së personit fizik mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave

Organizatat jofitimprurëse, entet shtetërore, personat “i vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant”, si dhe “kryefamiljari, që punëson persona si punëtorë shtëpie” regjistrohen në administratën tatimore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, datë 9.02.2012. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 12, datë 29.02.2012.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 143/2015, datë 17.12.2015. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 244, datë 11.01.2016.)

Neni 8

Llogaritja e kontributeve për punëmarrësin

1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale dhe nivelit maksimal të pages, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, e cila nuk mund të jetë më e vogël nga paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 143/2015, datë 17.12.2015. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 244, datë 11.01.2016.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, datë 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, datë 11.08.2014.)

Neni 9

Llogaritja e kontributeve për personin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes

1. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjësën e papaguar të familjes, llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje mbi pagën minimale të miratuar për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjësën e papaguar të familjes, llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje mbi dyfishin e pagës minimale të miratuar për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. (Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

(Paragrafi shfuqizohet me Vendim të Gjykatës Kushtetuese Nr. 60, datë 16.09.2016. Botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 20 shtator 2016.

2. Në rast se veprimtaria ekonomike ndërpritet për njëperiudhë, vlera e kontributit për t'u paguar zvogëlohet përpjesëtimisht, në përputhje me formulën e përcaktuar në udhëzimet e Ministrit të Financave, të nxjerra në zbatim të këtij ligji. (Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

Neni 10

Detyrimi për të deklaruar

1. Personi juridik dhe fizik i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë, në formë elektronike, në organin tatimor të dhënat e detyrimeve për kontributet në total dhe për çdo individ.

2. Personat juridikë dhe fizikë që janë të detyruar të paguajnë kontribute deklarojnë, në formë elektronike, në organin tatimor, të dhënat e detyrimeve për kontributet, sipas deklaratës përkatëse, ku, përveç të tjerave, deklarohet për çdo person emri e mbiemri, numri personal, paga, shuma për t'u paguar e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, si dhe e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

3. Forma, përmbajtja dhe rregullat e deklarimit, në organet tatimore, të kontributeve dhe ndryshimit të numrit të punonjësve, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

Neni 11

Afatet e deklarimit dhe te pagesës

1. Deklarimet e parashikuara në nenin 10 dhe pagesa e kontributeve bëhen në afatet e mëposhtme:

a) nga personat juridike, përjashtuar personat juridike të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Kur pronaret e personave juridike ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratore ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

b) nga personat fizikë, përjashtuar personat fizikë të regjistruar si tatimpagues të të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. Deklarata në këtë rast do të përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar të familjes si dhe të punësuarit.

c) nga personat juridike të regjistruar si tatimpagues të të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Kur pronaret e personave juridike ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratore ose çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër;

ç) nga personat fizike të regjistruar si tatimpagues të të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për

biznesin e vogël, brenda datës 20 te muajit te pare pas përfundimit te çdo tremujori te vitit kalendarik. Deklarata ne këtë rast do te përfshijë personat e vetëpunësuar, punonjësit e papaguar te familjes, si dhe te punësuarit.

Pika 2 shfuqizohet.

3. Personi juridik e fizik është i detyruar të deklarojë zyrtarisht, në organin tatimor, çdo punonjës që fillon punë për herë të parë te subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës.

Të larguarit nga puna subjektet duhet t'i deklarojnë zyrtarisht në organin tatimor brenda 10 ditëve kalendarike nga data e largimit. Këto deklarata shërbejnë si deklarime edhe për Inspektoratin Shtetëror të Punës, siç përcaktohet në nenin 22, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006, "Për Inspektoratin e Punës", të ndryshuar, dhe i vihen në dispozicion këtij të fundit nga ana e administratës tatimore në rrugë elektronike

(Ndryshuar me Ligjin Nr. 9164, date 18.12.2003. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 105 date 31.12.2003)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 9329, date 6.12.2004. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 103, date 29.12.2004)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 9457, date 21.12.2005, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 105, janar 2006.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, date 9.02.2012. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 12, date 29.02.2012.)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

Neni 12

Vendi i pagesës

1. Kontributet paguhen ne bankat, te cilat kane marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme te Tatimeve, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me "Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor"

2. Pagesa ne valute këmbehet ne leke, sipas kursit zyrtar te këmbimit ditën kur behet pagesa.

3. Procedurat për pagesën e kontributeve përcaktohen ne udhëzimin e Ministrit te Financave, ne zbatim te këtij ligji.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

Neni 13

Rimbursimi i kontributeve te paguara mbi vlerën e duhur

1. Nëse si rezultat i një kontrolli, konstatimi apo vlerësimi shuma e kontributeve të paguara e tejkalon shumën e llogaritur të detyrimit për kontributin, organi përkatës rimbursion diferencën, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Nëse te gjitha ose pjese te kontributeve te paguara lidhen me kontributet e punëmarrësit, punëdhënësi është përgjegjës për rimbursimin e punëmarrësve brenda 30 ditëve.

Fjalja shfuqizohet. (Ndryshuar me Ligjin Nr. 9164, date 18.12.2003. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 105 date 31.12.2003)

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, date 9.02.2012. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 12, date 29.02.2012.)

Neni 14

Masat shtrënguese

Nëse kontributet nuk paguhen në kohe, organi përkatës ka të drejte të marre masa shtrënguese, në përputhje me "ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, date 9.02.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 12, date 29.02.2012.)

Neni 15

Mbajtja e regjistrimeve

Punëdhënësi duhet të mbajë regjistrime për periudhën e marrëdhënieve të punës dhe shumat e paguara në para ose si përfitime në natyrë, për çdo punëmarrës, sipas përcaktimeve të bëra në Kodin e Punës dhe me vendim të Këshillit të Ministrave. Këto regjistrime u vihen në dispozicion punonjësve të autorizuar të administratës tatimore sa herë që kërkohet prej tyre.

Tatimpaguesi duhet të vendosë në listëpagesë numrin personal të çdo punonjësi. Tatimpaguesi i jep çdo punëmarrësi një formular me të dhënat, të ndara sipas muajve, për pagën, kontributet dhe tatimin e paguar gjatë periudhës së punësimit brenda një viti kalendarik.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, date 9.02.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 12, date 29.02.2012.)

KREU III KONTROLLI

Neni 16

Kontrolli i organeve tatimore

1. Organet tatimore kanë të drejte të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratat dhe pagesat e kontributeve të detyrueshme janë të plota dhe të sakta.
2. Për ushtrimin e kontrollit organet tatimore kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ato të kontrollit tatimor, në mbështetje të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 17 shfuqizohet.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, date 9.02.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 12, date 29.02.2012.)

Neni 18

Vlerësimi

Kur organet tatimore zbulojnë se kontributet nuk janë llogaritur në masën e duhur, bëjnë vlerësime. Për vlerësimet, mbledhjen e detyrimeve për kontributet, kamatëvonesat e gjobat, si dhe radhën e pagesës së tyre, zbatohen rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar afatin e parashkrimit të detyrimeve.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.)

KREU IV KAMATEVONESAT DHE GJOBAT

Neni 19

Kamatëvonesat për pagesën e vonuar

1. Nëse kontributet nuk paguhen në kohe, mbahen **kamatevonesa** për pagese të vonuar. **Kamatevonesat** nuk falen nga asnjë autoritet.
2. Masa e **kamatevoneses** për pagese të vonuar është ajo e përcaktuar në "ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. (Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, datë 9.02.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 12, datë 29.02.2012.)

Neni 20

Kundërvajtjet administrative dhe gjobat

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, që përbëjnë kundërvajtje administrative, dhe gjobat përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".
(Ndryshuar me Ligj Nr. 143/2015, datë 17.12.2015. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 244, datë 11.01.2016.)

KREU V APELIMET

Neni 21 E drejta e apelit

1. Çdo person, që detyrohet të paguajë kontribute, gëzon të drejtën e apelit për vlerësimin e kontributit shtese të **kamatevonesave** ose gjobave.
2. Çdo punëmarrës ka të drejtën e apelit për llogaritjen e vlerës së kontributit, të mbajtur nga punëdhënësi.
(Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, datë 9.02.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 12, datë 29.02.2012.)

Neni 22

Procedura e apelit

1. Çdo i punësuar mund të apelojë me shkrim pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore për llogaritjen e shumës së kontributeve të mbajtura nga punëdhënësi.
2. Punëdhënësi dhe personi i vetëpunësuar mund të apelojnë me shkrim në organet tatimore, në përputhje me dispozitat e **ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar.
(Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, datë 9.02.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 12, datë 29.02.2012.)

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 23 Dispozita kalimtare

1. Ky ligj zbatohet ndaj personave, të cilët, me vendim të Këshillit të Ministrave, janë të detyruar të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore.
2. Këshilli i Ministrave përcakton grupet e personave, të cilët detyrohen të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore, si dhe afatet dhe procedurat përkatëse.

3. Te gjitha kontributet, qe lindin para datës se hyrjes ne fuqi te këtij ligji, mblidhen ne përputhje me ligjet nr.7703, date 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nr.7870, date 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

4. Personat, te cilët nuk janë te detyruar te paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ne organet tatimore, do t'i paguajnë këto kontribute ne Institutin e Sigurimeve Shoqërore, ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave te nxjerre aktet nënligjore ne zbatim te neneve 4, 5, 8, 9 dhe 23 te këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Financave te nxjerre udhëzimet përkatëse, ne zbatim te neneve 7, 9, 10, 11 dhe 12 te këtij ligji.

Neni 25

Shfuqizime

Çdo dispozite, qe bie ne kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 26

Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky Ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare

Ky Ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare

Ky Ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në 1 Janar 2016.

**KRYETARI
SERVET PELLUMBI**

Ky Ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në 1 Janar 2016.

Ndryshuar me Ligjin Nr. 9164, date 18.12.2003. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 105 date 31.12.2003

Ndryshuar me Ligj Nr. 9329, date 6.12.2004. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 103, date 29.12.2004.

Ndryshuar me Ligj Nr. 9457, date 21.12.2005, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 105, janar 2006.

Ndryshuar me Ligj Nr. 9933, date 26.6.2008. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 112, data 21.07.2008

Ndryshuar me Ligj Nr. 10/2012, date 9.02.2012. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 12, date 29.02.2012.

Ndryshuar me Ligj Nr. 87/2014, date 17.07.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 126, date 11.08.2014.

Ndryshuar me Ligj Nr. 143/2015, date 17.12.2015. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 244, date 11.01.2016.

**Paragrafi shfuqizohet me Vendim të Gjykatës Kushtetuese Nr. 60, datë 16.09.2016.
Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 20 shtator 2016.**